



Komuna e Shtimës

Zyra e Prokurimit

Nr. 03 / 1 / 002

Datë 25 / 03 / 2019

KONTRATË PËR SHËRBIM

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson Muhadin Halili, Drejtor i Prokurimit në njërën anë:

dhe

Radio Zëri i Shtimës me pronar: Eljesa Ahmeti, adresa: Rr. „Adem Jashari „ - Shtime Tel. 044-111- 560 në anën tjetër, janë pajtuar për „ *Shërbimet e Informinit Publik në Komunën e Shtimes*

(*Procedur e Negociuar*)

,në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për: *Shërbimet e Informinit Publik në Komunën e Shtimes*

me numër Identifikues 617-2019-007-235

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë :

1.2 **Radio Zëri i Shtimës** në pajtim me kushtet e negociuara do të kryej shërbimet për Komunën e Shtimes .

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 25.03.2019 dhe përfundon me 31.12.2019

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 1 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i kryerje së shërimeve do të jenë varrezat e të gjitha vendbanimeve në teritorin e Komunës.

1.5 Incotermini i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi 2,490.00 €
(Dymijë e katërqindë e nëntëdhjetë euro)

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën e pagesës në bazë të faturës mujore për shërbimin e kryer të dëshmuar me raport të pranimit nga pesoni i autorizuar në Kontratë (Menagjeri i Kontartës)

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

Neni 7 Garancioni N/A

7.1 OE është i obliguar që shërbimet ti kryej konform kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë

organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Elejsa Ahmeti	Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Pronar	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	25.03.2019	Data:	25.03.2019
Vula:		Vula:	

Aktiviteti	Njësia (Ditë)	Sasia (Transmetim)	Çmimi	Shuma në Euro
Njoftimet për mbledhjet e Kuvendit	10	10	10	100
Njoftimi për debate publike (Draft-Rregulloret e Kuvendit)	11	11	10	110
Njoftim për 9 Majit – Ditën e Evropës	1	5	10	50
Njoftim për shënimin e 1 Majit – Ditën e punës	1	5	10	50
Njoftim për shënimin e Ditës së Çlirimit 12 Qershori	1	7	10	70
Njoftim për 26 Korrikun - Ditën e Dëshmorëve të Komunës	1	7	10	70
Njoftim për aktivitetet për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë	7	7	20	140
Njoftim për fillimin e vitit shkollor 2018/2019	7	7	20	140
Njoftim për aktivitetet e 28 Nëntorit	10	5	20	100
Ftesë për mbledhje publike me qytetarë	8	8	20	160
Transmetim i drejtpërdrejtë i seancave të Kuvendit Komunal	10	10	100	1000
Njoftime dhe shkresa të ndryshme	7	15	20	300
Lajmërime për debate me qytetarë	2	2	20	40
Njoftimi për debatin vjetor me qytetarë	8	8	20	160
TOTALI				2490

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	RADIO ZERI I SHITES
ADRESA E PLOTE	RRUGA: ADEM JASHARI NR.27 SHITE 72000
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	ELJESA AHMETI
POZITA	PRONAR, DREJTOR EKZEKUTIV
NENSIKRIMI	<i>[Signature]</i>
DATA	12.03.2019
VULA	

